

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6151
E enjte, 29 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Salih Mustafa deklarohet i pafajshëm ndaj aktakuzave të Speciales

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEKË BERISHA | FAQE 4-5



AAK-ja QËNDRON PAS KANDIDATURËS SË HARADINAJT PËR PRESIDENT

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Bekë Berisha, ka thënë se vendi është duke kaluar në një situatë të rëndë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se, pavarësisht prej mospajtimeve për tema të caktuara, koalicioni qeverisës është duke funksionuar. Sa i përket çështjes së presidentit të Kosovës, Berisha ka thënë se AAK-ja qëndron fuqishëm pas kandidaturës së Ramush Haradinajt për president. Ai ka thënë se LDK-ja do të ishte mirë që ta përkrahë kandidaturën e Haradinajt për president. Bekë Berisha në këtë intervistë ka folur edhe për mundësinë e kandidimit të tij për kryetar të Komunitetit të Istogut në zgjedhjet lokale që do të mbahen në vitin e ardhshëm

HOTI: INTEGRIMI EVROPIAN MBETET PRIORITY



Kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije se integrimi evropian mbetet prioritet, krahas çështjeve me të cilat është duke u marrë qeveria çdo ditë. Në tryezën e këshillimeve me organizatat e shoqërisë civile për prioritetet e Agjendës së re të

Reformave Evropiane (ERA II), ai ka thënë se Kosova i ka qarta sfidat me të cilat po përballlet në këtë rrugë. Hoti ka treguar se dialogu i nivelit të lartë BE - Kosovë për ERA II nuk do të mbetet në nivel të konsultimit me shoqërinë civile | FAQE 3

Rreth
3 milionë
euro të
shpenzuara
nga komunat
për vendime
të gjykatave



FAQE 5

AKTUALE



KATËR VIKTIMA DHE 281 TË
INFEKTUAR ME COVID NË
KOSOVË F. 7

SOT NË BRUKSEL DISKUTOHET
PËR ZGJIDHJEN E
PRETENDIMEVE FINANCIARE
DHE PËR ÇËSHTJET E PRONËS F. 3

SELIMI: REPUBLIKA E KOSOVËS
FITON DY KONTESTE NË VLERË
TOTALE 2.8 MILIONË EURO F. 6



EKONOMI



EDHE BIZNESET JOAKTIVE
PËRFITUAN NGA FONDI PËR
RIMËKËMBJE F. 9

GAP-i: PANDEMIA COVID
SHKAKTOI RËNIEN MË TË LARTË
TË PRODHIMIT VENDOR QË NGA
PASLUFTA F. 8

SPORT

BALLKANI MUND PRISHTINËN F. 14

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Salih Mustafa deklarohet i pafajshëm ndaj aktakuzave të Speciales

HAGË, 28 TETOR - Ish-eprori i UÇK-së, Salih Mustafa, është deklaruar i pafajshëm për katër akuzat e ngritura ndaj tij nga Gjykata Speciale. Në fjalimin e tij para Speciales, Mustafa të mërkurën është shprehur i bindur se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë. "Duke qenë thëllë i bindur se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë, e pashmangshme dhe e domosdoshme, sepse regjimi i gjatë në përmasa gjenocidiale i Sllobodan Millosheviqit si dhe pas luftërave të përgjakshme të këtij kasapi,

mua dhe popullit tim nuk na kishte lënë zgjidhje", ka thënë Mustafa.

Seanca e radhës ndaj Salih Mustafës në Gjykatën Speciale pritet të mbahet në dhjetor. Kështu janë marrë vesh palët. Në këtë seancë është diskutuar edhe për çështjet teknike, po ashtu edhe për fazën se ku gjenden hetimet e prokurorisë dhe ato të mbrojtjes. Avokati i Mustafës, Julius Von Bonne, ka thënë se hetimet janë bërë më të vështira për shkak të situatës me Covid-19, veçanërisht në Holandë.



Kur do të vijë vakcina kundër Covidit në Shqipëri?



TIRANË, 28 TETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri, Ogerta Manastirliu, ka shpërndarë një video ku profesori Eduart Kakarriqi flet për vaksinën Covid-19, e cila, sipas tij, pritet të jetë gati në fund të këtij viti ose në fillim të vitit që vjen. Kakarriqi thotë se Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje me kompaninë Covax dhe menjëherë sapo të dalë në treg vakcina do të sigurojë një sasi për 30 për qind

të popullatës së Shqipërisë. "Ka tri-katër firma të ndryshme industriale që pretendojnë dhe thonë se jemi thuajse gati që deri në fund të vitit ta nxjerrin vaksinën në treg. Mendohet se pjesa më e madhe e mendimeve është se vakcina do të jetë gati vitin që vjen. Ne si vend kemi marrë masa. Kemi nënshkruar marrëveshje me Covax. Ne jemi gati që sa të dalë vakcina vendi ynë do të jetë një ndër vendet që përfiton blerjen në kohë të një

sasie rreth 30 për qind të popullatës së vendit tonë duke pasur parasysh që në fokus janë mosha e tretë, grupet me risk dhe moshat pediatrike. Ne kemi një 'vaksinë' (në thonjëza) në dorë që nuk është gjë tjetër përveç masave. Një ndër këto masa, krahas distancimit dhe higjienës, është mbajtja e maskës. Maska duhet të bëhet zakon. Të mbahet jo vetëm në vendet e mbyllura, por edhe jashtë", ka thënë Kakarriqi.

Një 24 vjeç arrestohet pasi tentoi t'i korruponte punonjësit e policisë kufitare

TIRANË, 28 TETOR (ER) - Policia Kufitare e Rinasit ka arrestuar një 24 vjeç pasi ai ka tentuar t'i korruponte punonjësit e policisë kufitare me 50 euro. "Si rezultat i shtimit të kontrolleve në zbatim të masave parandaluese për moslejimin e udhëtimit drejt vendeve të BE-së të atyre shtetasve që nuk plotësojnë kushtet për të lëvizur në hapësirën Shengen, shërbimet e Policisë Kufitare në Rinas kanë arrestuar në

flagrancë, për veprën penale 'Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike', shtetasin L. L., 24 vjeç, banues në Tiranë. Arrestimi i tij është bërë pasi gjatë kontrollit të dokumentacionit dhe intervistimit për qëllimin e udhëtimit në vendet e BE-së, ky shtetas, duke qenë se ai nuk justifikonte qëllimin e lëvizjes dhe nuk plotësonte kushtet për të udhëtuar në hapësirën Shengen, i ka ofruar punonjësit

të Policisë 50 euro, për ta lejuar që ta vijonte udhëtimin", ka njoftuar Policia e Shqipërisë. Policia Kufitare bën thirrje për të gjithë shtetasit që duan të udhëtojnë drejt vendeve të BE-së, që në rast se nuk plotësojnë kushtet për të lëvizur në hapësirën Shengen, të mos ndërmarrin asnjë veprim të kundërligjshëm, të mos përpiqen t'i korruptojnë punonjësit e policisë pasi do të përballen me ligjin.



Meta u shkruan letër Ramës, Ruçit dhe Manastirliut: Gjendja me pandeminë po përkeqësohet



TIRANË, 28 TETOR (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, u ka dërguar letër zyrtare kryeministrit Edi Rama, kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçit dhe ministres së Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, në lidhje me situatën e pandemisë Covid-19 në këtë vend. "Nisur nga përkeqësimi i dukshëm i situatës së pandemisë

Covid-19, me shtim të numrit të personave të infektuar e, fatkeqësisht, me rritje edhe të numrit të qytetarëve të cilët kanë humbur jetën, shtrohet si domosdoshmëri një rivlerësim tërësor i situatës dhe masave të marra në raport me të, duke konsideruar edhe afrimin e stinës së ftohtë si një tjetër

faktor rëndues. Me përshkallëzimin e krizës së rëndë politike dhe institucionale, veçanërisht pas shkeljes brutale e të njëanshme të marrëveshjes konsensuale të 5 qershorit, situata e pandemisë pritet të përkeqësohet drejt një katastrofe, që duhet parandaluar në kohë", ka shkruar presidenti Meta.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur tryezën konsultative me organizatat e shoqërisë civile për prioritetet e Agjendës së re të Reformave Evropiane (ERA II)

Hoti: Integrimi evropian mbetet prioritet



Kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije se integrimi evropian mbetet prioritet, krahas çështjeve me të cilat është duke u marrë qeveria çdo ditë. Në tryezën e këshillimeve me organizatat e shoqërisë civile për prioritetet e Agjendës së re të Reformave Evropiane (ERA II), ai ka thënë se Kosova i ka qarta sfidat me të cilat po përballlet në këtë rrugë. Hoti ka treguar se dialogu i nivelit të lartë BE - Kosovë për ERA II nuk do të mbetet në nivel të konsultimit me shoqërinë civile

prioritetet e kësaj agjende janë ndarë në 3 shtylla dhe duhet të implementohen deri në fund të vitit 2022. Shtylla e parë: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit. Shtylla e dytë: konkurrueshmëria, klima e investimeve. E treta ka të bëjë me arsimin dhe shëndetësinë”, ka thënë Selmanaj.

Në këtë tryezë ka qenë i pranishëm edhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, i cili ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që të fokusohen tek implementimi i Agjendës Evropiane të Reformave. Szunyog ka thënë se pret që në këtë proces shoqëria civile të luajë rol kyç. “Fokusi duhet të jetë në përmbushjen e ERA II ku presim që shoqëria civile të luajë rol kyç. Ne presim reforma konkrete dhe solide që përcaktohen me ERA II. Pres që të ecet tutje me procesin e reformatizimit”, ka thënë Szunyog.

Qasja e re e qeverisë për përfshirje të përfaqësuesve të shoqërisë civile është mirëpritur nga pjesëmarrësit, duke u vlerësuar e domosdoshme për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane (ERA II).

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 TETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka deklaruar se procesi i integritimit evropian të Kosovës do të jetë prioritet i qeverisë së tij. Në tryezën konsultative me organizatat e shoqërisë civile për prioritetet e Agjendës së re të Reformave Evropiane (ERA II), ai ka thënë se Kosova do t'i realizojë obligimet që ndalin nga ky procesi.

Hoti ka bërë me dije se dialogu i nivelit të lartë BE - Kosovë për ERA II nuk do të mbetet në nivel konsultimi me organizatat e shoqërisë civile, por do të avancojë tutje, duke i bërë ata pjesë të bashkëpunimit për hartimin e planeve të veprimit dhe mbikëqyrjes. “Integrimi evropian mbetet prioritet, krahas çështjeve me të cilat po merremi në baza ditore, veçanërisht me menaxhimin e pandemisë dhe problemet

ekonomike dhe sociale që i ka shkaktuar ky infeksion”, ka deklaruar Hoti.

Ai është zotuar se do t'i marrë parasysh rekomandimet e shoqërisë civile. “I kemi të qarta sfidat me të cilat po përballlemi, sfida të cilat janë në raportin për Kosovën dhe po punojmë shumë që të bëjmë plan pune nëpër ministritë përkatëse për adresimin e atyre sfidave. Besoj sot do të diskutojmë dhe ta prezantojmë një dokument shumë të rëndësishëm ERA II, për të cilin besoj se do të marrim sugjerime dhe komente edhe nga ana e juaj. Le të jetë ky takimi i parë ku ne fillojmë takimet me shoqërinë civile e cila mbikëqyrë agjendën e qeverisë në të gjitha aspektet, por edhe në atë të integritimit evropian”, ka deklaruar kryeministri.

Ndërsa zëvendëskryeministri Driton Selmanaj ka treguar për qëllimet e ERA II. “Qëllimi i ERA II është që të shërbejë si një instrument për ta shtyrë

përpara zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA) dhe reformave të tjera fundamentale që do ta avancojnë procesin e integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian”, është shprehur Selmanaj.

Ndër të tjera, ai ka thënë se prioritetet janë ndarë në tri shtylla. “Këto prioritetet janë negociuar me Komisionin Evropian për disa muaj. Era II ka për qëllim që ta shtyjë përpara implementimin e agjendës evropiane. Gjatë përgatitjes së ERA II,

Selmanaj do të jetë zëvendëskryeministër për integritime evropiane

Zëvendëskryeministri Driton Selmanaj nga dita e mërkurë do të jetë përgjegjës për procesin e integritimit evropian të Kosovës. Në tryezën e konsultative me Shoqërinë Civile për prioritetet e Agjendës së Reformave Evropiane, kryeministri Hoti ka thënë se Selmanaj do të jetë përgjegjës edhe për

menaxhimin e instrumentit ERA II. “Zëvendëskryeministri Selmanaj do ta mbulojë pjesën e integritimeve evropiane, pra do të jetë zëvendëskryeministër për çështje të integritimeve evropiane. Ai ka përvojë të gjatë në shoqërinë civile. Besoj me shumicën prej jush njihet edhe personalisht, ose

mund të keni punuar bashkë. Dhe unë besoj se së bashku me ju dhe stafin i cili është mjaft i përgatitur brenda zyrës dhe departamenteve që mbulojnë çështjet e integritimeve evropiane të punojnë së bashku në çuarjen përpara të agjendës evropiane”, ka deklaruar Hoti.

Haradinaj takohet me presidentin Thaçi, temë diskutimi zhvillimet aktuale në vend

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, është takuar të mërkurën me presidentin Hashim Thaçi. Ai ka thënë se ky ishte një takim me ftesë të presidentit Thaçi për konsulta rreth zhvillimeve

në vend. “Diskutoam për gjendjen në vend dhe për pandeminë”, ka thënë Haradinaj, duke shtuar se në këtë takim nuk është diskutuar për postin e presidentit. “Jo, nuk kemi biseduar për këtë temë”, ka thënë ai. Haradinaj ka treguar se në

korridor të ndërtesës së Presidencës dhe të Kuvendit, ka parë edhe liderin e LDK-së, Isa Mustafa, por nuk e di nëse edhe ai ishte nisur për takim të Thaçi. “E takova në korridor zotërinë Mustafa. Nuk e di nëse ka pasur ndonjë takim me presidentin”, ka thënë Haradinaj.



Flet për “Epokën e re”, Bekë Berisha

AAK-ja QËNDRON PAS KANDIDATURËS SË HARADINAJT PËR PRESIDENT

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Bekë Berisha, ka thënë se vendi është duke kaluar në një situatë të rëndë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se, pavarësisht prej mospajtimeve për

tema të caktuara, koalicioni qeverisës është duke funksionuar. Sa i përket çështjes së presidentit të Kosovës, Berisha ka thënë se AAK-ja qëndron fuqishëm pas kandidaturës së Ramush Haradinajt për president. Ai ka thënë se LDK-ja do të ishte mirë që ta

përkrahë kandidaturën e Haradinajt për president. Bekë Berisha në këtë intervistë ka folur edhe për mundësinë e kandidimit të tij për kryetar të Komunës së Istogut në zgjedhjet lokale që do të mbahen vitin e ardhshëm

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 TETOR -

“Epoka e re”: Z. Berisha, si është duke ecur puna në koalicion? Kohën e fundit AAK-ja ka filluar ta kritikojë kryeministrin Hoti. Kur Haradinaj e kritikoi për Taskë Forcën, kjo u pa si presion për postin e presidentit?

Berisha: Ne si shtet jemi duke kaluar në një situatë goxha të rëndë, me shumë probleme. Normalisht se jo çdoherë pajtohemi për tema të caktuara, mirëpo këto janë në vazhden e punëve që po kryhen dhe nganjëherë kemi dhe mospajtime. Pra, këto janë në suaza të normales të komunikimit të një koalicioni që po funksionon në një kohë të vështirë.

“Epoka e re”: AAK-ja po insiston në kandidaturën e Haradinajt për president?

Berisha: Ne qëndrojmë fuqishëm pas kandidaturës së z. Haradinajt për president. Mendojmë se në situata të vështira si shtet duhet ta kemi një president me integritet, që është i zoti, i qëndrueshëm dhe që ka përvojë në jetën politike dhe kombëtare. Nuk mendoj se në skenën politike aktualisht ka njerëz më kredibilë dhe më të fuqishëm që do ta kishte përfaqësuar Kosovën edhe në arenën ndërkombëtare, por edhe që do të mund të përballej me problemet që ka Kosova sesa z. Ramush Haradinaj.

“Epoka e re”: Në rast se LDK-ja nuk lëshon rrugë në këtë pikë?

Berisha: Ne kemi prezantuar kandidaturën e z. Haradinajt për president dhe në këtë pikë mund të ketë kundërshtime, mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk do të merremi vesh dikur edhe për mbështetjen ndaj Haradinajt për president. Mos të harrojmë se z. Haradinaj e pati përkrahur edhe Ibrahim Rugova për kryeministër, në një situatë shumë të vështirë,



prandaj edhe LDK-ja e sotme, në qoftë se ka mbetur diçka prej asaj LDK-së, është mirë ta përkrahë Ramush Haradinajn për president.

“Epoka e re”: Në rast se nuk do ta keni përkrahjen nga LDK-ja, do ta çojë AAK-ja vendin në zgjedhje, me dalje nga koalicioni?

Berisha: Ky është parashikim, e

unë nuk jam bash i këtyre parashikimeve.

“Epoka e re”: Sa iu përket zgjedhjeve lokale që janë në vitin e ardhshëm, AAK-ja është duke kandiduar kandidatët për kryetarë komunash. A do të kandidoheni për kryetar komune në Istog?

Berisha: Unë kam marrë kërkesa që të kandidohem. Jam

propozuar nga Këshilli Qendror dhe kryesia e AAK-së. Njëherë jam duke i shikuar mundësitë. Atje ndodhën disa gjëra të çuditshme si arrestimi i kryetarit Haki Rugova që është në proces. Ne po merremi edhe me komisione hetimore se çfarë ka ndodhur aty, a ka të bëjë Taskë - Forca apo shefi i policisë që u shkarkua. Pra, të shohim çfarë ka ndodhur aty.

Është kërkesë e qytetarëve që të kthehem dhe të kandidoj për kryetar komune në Istog. Kjo komunë ka vite që është e zymtë dhe nuk po shihet përparim. Qytetarët atje përballën me mungesë të gjërave bazike, andaj e ndiej të nevojshme t’u shërbej qytetarëve dhe të kandidoj në mënyrë që të kemi përparim sikurse në të gjitha qytetet e

tjera. Duhet të nisim me reforma. Duhet t'u japim mundësi të rinjve që kanë vizion. Ka raste kur një projekt zgjat 20 vjet dhe nuk përfundon, por edhe nëse përfundon, i ka 100 mangësi.

"Epoka e re": Do të thotë, do të jeni kandidat?

Berisha: Mund të them se Haki Rugova është duke e konsumuar mandatin e Gani Dreshajt. Nëse ju kujtohet, në zgjedhjet e fundit kishim dallim 12 vota dhe ato të diskutueshme. Ne e patëm fituar komunën. Haki Rugova është duke e konsumuar kryetarin e komunës që me

kemi të bëjmë me gjenocid. Me kontributin e të gjithë popullit të Kosovës e patëm larguar Serbinë nga Kosova. UÇK-ja bashkë me NATO-n e ka çliruar Kosovën dhe sot po bëhen 20 vjet që jemi të lirë. AAK-ja që në fillim nuk e ka përkrahur këtë gjykatë dhe është dashur që mos të përkrahet, kur ne e njohim historinë dhe sakrificën e popullit tonë dhe e dimë se kemi pasur të drejtë, sepse kemi bërë një luftë çlirimtare, mirëpo disa deputetë e kanë miratuar atë dhe ky proces tanimë nuk ndalet. Ky proces do të jetë i vështirë. Shteti i Kosovës i ka marrë masat, njerëzit janë ftuar dhe Gjykata Speciale ka filluar punën. Të tjerat tash janë veç opinione që mund t'i japin analistët. Mirëpo, fatkeqësisht, kjo do të vazhdojë. Do të ketë aktakuza të cilat do të trajtohen. Gjykata Speciale është proces i dhimbshëm dhe i mundimshëm.

"Epoka e re": Sa i përket grupit të Kumanovës, ka kërkesë nga familjarët e tyre prej kohësh që të ekstradohen në Kosovë. Çfarë do të bëhet për këtë në mandatin e kësaj qeverie?

Berisha: Deputetët tanë kanë bërë këtë kërkesë. Po ashtu, ministri ynë i Drejtësisë ka bërë një kërkesë që ky grup të transferohet dhe ta vuajë dënimin në Kosovë. Jemi duke u marrë intensivisht me këtë çështje. Nuk i kemi harruar as ata djem dhe as familjet e tyre.

"Epoka e re": Jeni pjesë e Komisionit Hetimor për procesin e privatizimit. Si është duke ecur puna në këtë komision?

Berisha: Procesi i privatizimit nga fillimi ka shkuar keq. Ekonomia e Kosovës në fillim është shkatërruar nga ajo çfarë kishte mbetur. Fabrikat që kanë mbetur, të cilat kanë pasur potenciale për prodhim dhe që kanë pasur produkte në stol me miliona, UNMIK-u dhe ndërkombëtarët kanë bërë politika për ta shuar ekonominë e Kosovës dhe pastaj për ta shitur lirë. Këtu dihet që ka pasur korrupsion çdo ditë. Po shihet se ka pasur korrupsion dhe që ai proces nuk ka shkuar mirë. Kjo ka qenë edhe arsyeja që të formohet Komisioni Hetimor. Ne nuk jemi gjykatë. Këtë çështje do ta trajtojmë politikisht dhe në fund do të dalim me të gjetura tona, pastaj do të shihet nëse ka materie për ta çuar këtë punë në gjykatë. Qëllimi është i mirë, sepse ka të bëjë me ekonominë e Kosovës.

vota e kishte fituar Gani Dreshaj.

"Epoka e re": Sa i përket Gjykatës Speciale, e shihni si mundësi zhbërjen e kësaj gjykate?

Berisha: E para, Kosova e ka bërë një luftë mbrojtëse dhe për çlirim. Ne kemi 13 mijë viktima, ndër ta 1 000 e më shumë fëmijë dhe gra dhe

Sot në Bruksel diskutohet për zgjidhjen e pretendimeve financiare dhe çështje të pronës

Qeveria e Kosovës ka konfirmuar se sot (e enjte) në Bruksel delegacionet në nivel ekspertësh, të Kosovës dhe të Serbisë, do të takohen pas më shumë se një muaji pauzë të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Temë e diskutimit do të jetë zgjidhja e pretendimeve financiare dhe çështja e pronës midis dy vendeve. Delegacioni i Kosovës në këtë takim përfaqësohet nga koordinatori shtetëror Skender Hyseni

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 TETOR - Me ftesë të emisarit special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, delegacioni i Kosovës, i prirë nga koordinatori shtetëror Skender Hyseni, ka udhëtuar të mërkurën për në Bruksel, ku sot (e enjte) pritet të zhvillohet takimi i radhës me delegacionin nga Serbia. Temë e diskutimit do të jetë zgjidhja e pretendimeve financiare dhe e çështjeve të pronës midis dy vendeve. Me ndërmjetësimin e emisarit Lajçak, në këtë takim delegacionet do ta vazhdojnë diskutimin e filluar në takimin e kaluar rreth kësaj çështjeje. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka rinisur gjatë kësaj vere dhe deri më tani janë zhvilluar disa takime si në nivel të lartë ndërmjet kryeministrit



të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, por edhe mes delegacioneve në nivel ekspertësh.

Por, për më shumë se një muaj nuk ka pasur takime ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë dhe njëri prej shkaqeve ishte refuzimi i Kosovës për të

biseduar rreth asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë dhe insistimi i Serbisë që të bisedohet për këtë temë si prioritet. Për të përgatitur takime të reja, në Kosovë dhe Serbi, para një jave kishte qëndruar i dërguari i posaçëm i BE-së për dialog, Miroslav Lajçak.

Trumpi flet sërish për dialogun Kosovë - Serbi: E ndalëm luftën 400-vjeçare!

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i ka vazhduar tubimet zgjedhore para zgjedhjeve presidenciale. Ai ishte në Nebraska dhe gjatë fjalimit nuk harroi që përsëri të mburrej me marrëveshjen e nënshkruar në Uashington në shtator në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se i kanë ndaluar 400 vjet vrasje me tyre. "A e dini se jam nominuar për tri Çmime Nobel për Paqe? A mund ta besoni këtë?", tha ai para përkrahësve para se ata të

shpërthenin në brohoritje. "Dhe për rajone të ndryshme, si në mes të Kosovës dhe Serbisë, jemi duke bërë marrëveshje. Marrëveshje tregtare. Unë thashë: Pritni një minutë, a nuk e luftojnë ato njëra-tjetrën gjithmonë? Po. Për shumë dekada. Si e dite? Unë thashë: E di, ata e luftojnë njëri-tjetrin tërë kohën", shtoi kreu i Shtëpisë së Bardhë. Më pas, ai tha: "Tregojuni se ne nuk do të bëjmë kurrfarë biznesi me ta. Ata e duan biznesin tonë, apo

jo?! Nuk do të bëjmë kurrfarë biznesi pa bërë marrëveshje që ata të ndalen së vrari njëri-tjetrin dhe e dini çka? Zgjati rreth 20 minuta", tha presidenti amerikan. "Ata kanë luftuar për 400 vjet. Unë mendoj se ata kanë luftuar për 400 vjet. Ata kanë qenë duke luftuar për një kohë të gjatë. Ata duan të bëjnë një marrëveshje. Krejt papritmas, dy muaj më parë, ata ishin në Zyrën Ovale, duke u përqaftuar e duke u puthur. Ishte gjë e lehtë", ka deklaruar Trumpi.

Selimi: Republika e Kosovës fiton dy konteste në vlerë totale 2.8 milionë euro

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 28 TETOR - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, të mërkurën ka mbajtur një konferencë për media, me ç'rast ka njoftuar opinionin publik se Republika e Kosovës ka fituar dy konteste në vlerë totale 2.8 milionë euro falë punës së Avokaturës Shtetërore si agjenci e pavarur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. "Tani kemi pranuar aktgjykimin nga departamenti ekonomik, ku është fituar një kontest në vlerë 1.8 milion euro, lëndë e përfaqësuar nga avokate Ilire

Tasholli Aydogan. Duke ditur se Avokatura Shtetërore përfaqëson edhe kontestet gjyqësore në gjykatat ndërkombëtare, që rast konkret kemi kontestin në Gjykatën e Vjenës, përfaqësuar nga avokat Arsim Zuka rast i fituar me një vlerë monetare prej një milion eurosh", ka thënë Selimi. Ministri Selimi ka thënë se falë një pune intensive, institucioni i Avokaturës Shtetërore po arrin të jetë i suksesshëm në mbrojtjen e buxhetit të Republikës së Kosovës. "Synoj ta kemi një sistem të qëndrueshëm funksional dhe të pavarur në përfaqësimin e



autoriteteve publike të administrative si dhe në Republikës së Kosovës, në procedurat gjyqësore, arbitrazh", ka deklaruar ministri Selimi.

Ndërsa avokati i përgjithshëm shtetëror, Sami Istrefi, ka thënë se gjatë muajve janar-tetor të vitit 2020, Avokatura Shtetërore ka mbrojtur një numër të madh të rasteve në gjykatat vendore, ku vlera e kontestit të fituar është 10 milionë e 183 mijë euro. "Të gjitha këto lëndë janë të fituara me vendimin e formës së prerë dhe ky është sukses jashtëzakonisht i madh", ka bërë me dije avokati Istrefi. Avokatura Shtetërore ka gjithsej 1935 lëndë të pranuar në vitin 2020, ku 462 prej tyre janë të fituara dhe 307 lëndë janë me ankesë në Gjykatën e Apelit, të tjerat janë në proces.

Zëvendësministri i Mbrojtjes: FSK-ja do të pranojë në radhët e veta kandidatët më të mirë pavarësisht prej përkatësisë etnike

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Muhametalli Mergjollari, ka vizituar të mërkurën Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, ku është pritur nga zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Mehmet Lladrovci. Ai e ka njoftuar atë për zhvillimet e përgjithshme aktuale të KDS-së, në veçanti për procesin e testimit të kandidatëve konkurrues për ushtarë aktivë të FSK-së.

Me qëllim të informimit më të hollësishëm, një prezantim të veçantë para zëvendësministrit Mergjollari e bëri shefi i Shtabit të KDS-së, nënkolonel Arsim Shaqiri, dhe ai i personelit, kapiten Florije Osmani. Nga ana e tij, zëvendësministri Mergjollari shprehu vlerësimin e lart për të arriturat e përgjithshme të KDS-së, duke shprehur interesimin e tij, me fokus në procesin e rekrutimit dhe fazës së testimit fizik të kandidatëve nga radhët e komuniteteve joshumicë. Më



pas, zëvendësministri Mergjollari vizitoi edhe stacionet e testimit, ku u njoftua nga afër dhe më gjerësisht me procesin dhe praktikat në zbatim duke takuar edhe kandidatët nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Me këtë rast, zëvendësministri Muhametalli Mergjollari përgëzoi stafin e KDS-së dhe të gjithë personelin e angazhuar në këtë proces, për angazhimin dhe profesionalizimin e lartë, edhe pse në kushte të pandemisë Covid-19 për realizimin sa më të suksesshëm të këtij procesi. Ai ka theksuar se është mirëpritur dhe vlerësuar shumë lart zbatimin i kriterëve, procedurave dhe standardeve më të larta të konkurrimit dhe testimit duke u mundësuar kandidatëve në përgjithësi dhe atyre nga radhët e komuniteteve joshumicë në veçanti, ofrimin e shanseve të barabarta, të vlerësimit real dhe të qasjes me transparencë të plotë. "Edhe kjo është dëshmi e fuqishme se FSK do t'i pranojë në radhët e veta kandidatët më të mirë pavarësisht prej përkatësisë etnike duke qenë gjithmonë në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim", ka thënë Mergjollari.

Rektori Bajraktari zgjedhet kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

FERIZAJ, 28 TETOR (ER) - Rektori i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), prof. dr. Agron Bajraktari, është zgjedhur kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, institucion ky i pavarur që mbikëqyrë kualifikimet kombëtare. Ndërsa nënkryetar i këtij këshilli është zgjedhur Arian Zeka nga Oda Ekonomike Amerikane. Rektori Bajraktari për tri vjet do

të udhëheqë Këshillin Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, i cili numëron 13 anëtarë që përfaqësojnë ministrinë, organizatat partnere shoqërore dhe universitetet publike e private të Kosovës. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka për mision ta mbikëqyrë dhe zhvillojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës në

partneritet me nxënësin /kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimin në të gjitha nivelet dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë. Vizioni i Autoritetit është krijimi i një sistemi cilësor të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.



Rekord i të infektuarve me Covid-19 në Kosovë

Katër viktima dhe 281 të infektuar me Covid në Kosovë

Gjendja epidemiologjike në Kosovë po shkon duke u përkeqësuar. Të mërkurën janë regjistruar katër vdekje nga Covid-19 dhe 281 raste të reja të infektimit. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, brenda 24 orëve të fundit janë shëruar 97 pacientë. Vetëm në Prishtinë janë regjistruar 150 raste të reja



Kosova nis procedurat për përdorimin e plazmës së gjakut për pacientët me Covid-19

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka nënshkruar të mërkurën aprovimin edhe të dy udhërrëfyesve të ri klinikë: Udhërrëfyesin për diagnostikimin dhe menaxhimin e tuberkulozit ekstrapulmonar dhe Udhërrëfyesin klinik për menaxhimin e infeksionit latent të tuberkulozit. Këta udhërrëfyes do t'u shërbejnë profesionistëve të tri niveleve të kujdesit shëndetësor që ta bëjnë menaxhimin më të mirë të infeksioneve me tuberkuloz, sipas mjekësisë së bazuar në dëshmi. Me këta dy

udhërrëfyes klinikë të aprovuar, numri i tyre ka arritur në 19. Prej fillimit të hartimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike, MSh-ja ka hartuar dhe aprovuar gjithsej 8 udhërrëfyes klinikë, ndërsa vetëm gjatë mandatit të ministrit Zemaj janë hartuar dhe aprovuar 11 udhërrëfyes klinikë. Ministri Zemaj ka falënderuar grupet punuese për hartimin e udhërrëfyesve klinikë, komisionin për vlerësim dhe Këshillin Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike për punën e tyre për nxjerrjen e këtyre

dokumente të rëndësishme për menaxhimin klinik të sëmundjeve të ndryshme. Gjithashtu, MSh-ja ka formuar sot edhe grupin punues për hartimin e protokollit për përdorimin e plazmës koaleshente të pacientët me Covid-19, me përbërje të ekspertëve të lëmenjve gjegjës. Ky është një hap para për fuqizimin e menaxhimit dhe trajtimit gjithëpërfshirës të infeksionit Covid-19. Grupi punues pritet që brenda afateve të përcaktuara ligjore ta finalizojë protokollin në fjalë.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në Kosovë janë regjistruar katër vdekje nga Covid-19 dhe 281 raste të reja.

IKShPK-ja ka treguar se rezultatet janë në bazë të 932 mostrave të testuara. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 932 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 281 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast Spitali i Përgjithshëm, Prizren, 1 rast Mjekimi Intensiv Qendror, QKUK, 1 rast Spitali i Përgjithshëm, Gjakovë dhe 1 rast Klinika Emergjente, QKUK)", ka njoftuar IKShPK.

IKShPK ka treguar se gjatë kësaj kohe janë shëruar 97 pacientë. "Numri total i rasteve pozitive është 18 626 raste nga 90 040 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 673 raste të të

vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 97 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 295 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 2 658", ka njoftuar IKShPK-ja.

Sa iu përket komunave, Prishtina vazhdon ta ketë numrin më të madh të rasteve, me 150 raste të reja. Pas saj renditet Fushë-Kosova me 22 raste. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 150 raste, komuna Fushë-Kosovë 22 raste, komuna Prizren 20 raste, komuna Gjilan 15 raste, komuna Vushtrri 15 raste, komuna Lipjan 8 raste, komuna Mitrovicë 8 raste, komuna Ferizaj 5 raste, komuna Suharekë 5 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Gjakovë 3 raste, komuna Podujevë 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Klinë, Pejë dhe Rahovec", ka njoftuar instituti, duke ftuar qytetarët që t'i respektojnë masat kundër virusit "Korona".

Rreth 3 milionë euro të shpenzuara nga komunat për vendime të gjykatave

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Lëvizja FOL, me mbështetjen e Friedrich Ebert Stifuting (FES), ka mbajtur diskutimin online, me ç'rast ka publikuar raportin "Shpenzimet e komunave për vendime të gjykatave janar-gusht 2020". Ky raport përfshinë gjetjet nga monitorimi i pagesave të ekzekutuara nga komunat e Republikës së Kosovës si rezultat i vendimeve të gjykatave për periudhën janar-gusht 2020.

Qëllimi i këtij raporti është informimi i publikut për shkallën e shpenzimeve që komunat i kanë paguar për vendime të gjykatave, përkatësisht se sa për qind të buxhetit të komunave për vitin 2020 janë destinuar për pagesat

e këtyre vendimeve.

Albana Hasani, nga Lëvizja FOL, tha se komunat e Republikës së Kosovës kanë vazhduar të ekzekutojnë pagesa të larta për vendime të gjykatave edhe gjatë periudhës janar-gusht 2020, përkundër faktit se gjatë kësaj periudhe gjykatat u obliguan të punojnë vetëm për raste të natyrës urgjente, në rrethin e të cilave këto lëndë nuk ishin të përfshira. "Gjatë periudhës janar-gusht 2020, komunat e Republikës së Kosovës për vendime të gjykatave kanë shpenzuar rreth 3 milionë euro, apo 8,47 për qind të buxhetit fillestar të paraparë për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës", ka thënë Hasani. Sipas saj, kjo ulje e theksuar e



pagesave të këtyre vendimeve në krahasim me vitet paraprake ka ardhur si rrjedhojë e situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë Covid-19 gjatë

muajit mars të këtij viti, ku gjykatat kanë punuar vetëm për raste të natyrës urgjente për katër muaj me radhë (rastet e dhunës në familje, rastet me

paraburgim dhe rastet për të mitur etj.), prandaj procedimi me lëndë të tilla të komunave, si lëndë të natyrës civile, ka qenë i pamundur gjatë asaj periudhe.

Abrashi viziton Komunën e Obiliqit, premtion mbështetje në projekte të reja

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka vizituar të mërkurën Komunën e Obiliqit, ku është pritur nga kryetari, Xhafer Gashi. Abrashi bashkë me Gashin kanë vizituar disa projekte infrastrukturore që janë duke u kryer në Komunën e Obiliqit, e që janë investim i Ministrisë së Infrastrukturës. Ministri Abrashi tha se në Obiliq janë duke u kryer projekte të rëndësishme infrastrukturore që do të

ndikojnë në zhvillimin e bizneseve dhe lidhjen e kësaj komune me fshatrat. "Në Obiliq janë duke u kryer projekte infrastrukturore të rëndësishme, por kisha veçuar këtu ndërtimin e sheshit të qytetit që është pothuajse në fazën përfundimtare dhe është projekt i Ministrisë së Infrastrukturës. Po ashtu, po vazhdon asfaltimi në lagjen 'Hade e Re', me total mbi gjashtë kilometra dhe në tërësi si projekt pritet të përfundojë në vjeshtën e vitit të

ardhshëm. Në Obiliq do të kemi edhe projekte të reja vitin e ardhshëm, për ta kompletuar infrastrukturën e kësaj komune", tha Abrashi. Ndërsa kryetari i Obiliqit, Xhafer Gashi, tha se bashkëpunimi i mirëfilltë institucional në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Obiliqit ka bërë që të realizohen projekte të rëndësishme infrastrukturore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve.



GAP-i: Pandemia Covid shkaktoi rënien më të lartë të prodhimit vendor që nga paslufta

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Masat parandaluese të pandemisë Covid-19 shkaktuan rënien më të lartë të prodhimit vendor që nga paslufta duke bërë që Prodhimi i Brendshëm Bruto në tremujorin e dytë të 2020-s të bie 9.28 për qind. Kështu thuhet në raportin "Ndikimi i pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës", prezantuar nga Instituti për Studime të Avancuara (GAP). Në këtë raport, paraqitet ecuria e komponentëve kryesorë të




PBB-së dhe indikatorët e tjerë makroekonomikë në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2020, me qëllim që ta pasqyrojë

ndikimin e kësaj krize në të gjithë sektorët ekonomikë të vendit. "Situata emergjente ndikoi në ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve ku ekonomitë familjare ngritën shpenzimet për produkte bazike, ndërsa reduktuan shpenzimet joesenciale. Aktivitetet ekonomike të cilat shënuan rritje në tremujorin e dytë ishin industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, dhe furnizimi me ujë me 19.8 për qind dhe informacioni dhe komunikimi me 29.6 për qind.

Ndërkohë rënie të të hyrave patën të gjitha industritë e tjera. Rënia më e lartë u shënuar në industrinë e ndërtimit me 47.08 për qind, dhe tregtia, transporti, akomodimi dhe gastronomia me 24.4 për qind. Po ashtu, gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti industritë deklaruan rreth 584 milionë euro ose 11 për qind më pak qarkullim në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak", thuhet në raport.

Ministri Mustafa në konferencë virtuale për avancimin e politikave për menaxhimin e pyjeve

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, mori pjesë në ngjarjen virtuale të fillimit të projektit "Përkrahje për fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve për ta përmirësuar jetesën në vendet rurale dhe adresimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë". Në fjalën e tij, ministri Mustafa tha se ky program do ta forcojë edhe më shumë administrimin e pyjeve. "Jemi duke punuar drejt rimëkëmbjes së plotë të sektorit të pylltarisë dhe mbetemi të përkushtuar për



ngritjen e pyjeve tona në kapacitetin, funksionalitetin dhe produktivitetin e tyre të plotë", tha ministri Mustafa. Më tutje, ministri i MBPZHR-së shtoi se ky projekt është

tejet i rëndësishëm, duke pasur parasysh që Republika e Kosovës, si pjesë e agjendës për aderim në Bashkimin Evropian, po vazhdon t'i përafrojë dhe harmonizojë

edhe ligjet për pyjet. "Si një vend i ri, me vullnet të madh, vazhdimisht po punojmë në një strategji dhe plan të ardhshëm për bujqësinë, pylltarinë dhe zhvillimin rural", tha ministri Mustafa. Ministri i MBPZHR-së shtoi se si ministri vazhdimisht po luftohet me zinxhirët e tregut informal të pyjeve dhe po pengohet prerja ilegale jo vetëm për hir të ekonomisë së Kosovës, por edhe për t'i mbrojtur dhe ruajtur pyjet, asetin kryesor në menaxhimin e ndryshimit klimatik. Në këtë ngjarje morën pjesë edhe Ambasadorja e Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck,

koordinatoresha për Zhvillim të Agjencive të Kombeve të Bashkuara, Ulrika Richardson, shefi i Seksionit të Bashkëpunimit të BE-së me Kosovën, Luigi Brusa, si dhe udhëheqësi regjional i Organizatës për Ushqim dhe Agrikulturë (FAO), Raimund Jehle. Ky projekt është bashkë organizim mes Organizatës për Ushqim dhe Agrikulturë (FAO) dhe Ambasadës së Suedisë në Kosovë dhe është i përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Hoti takoi bordin dhe menaxhmentin e Trepçës si dhe Sindikatën e Telekomit

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, bashkë me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, kanë takuar bordin dhe menaxhmentin e Trepçës, së cilës i është bllokuar llogaria për shkak të borxheve ndaj kreditorëve. Pavarësisht prej performancës së

mirë dhe rritjes së prodhimit për 28 për qind gjatë këtij viti, rënia e çmimeve në bursa dhe tregje ndërkombëtare e ka nxjerrë këtë kompani me afarizëm negativ. Trepça ka trashëguar kontrata të pafavorshme të cilat po i shkaktojnë dëme financiare. Prandaj, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit do të bashkëpunojë me bordin dhe

menaxhmentin e Trepçës, në përgatitjen e planit të biznesit për tejkalim të situatës. Kryeministri Hoti, bashkë me ministrin Kuçi, të mërkurën kanë takuar edhe Sindikatën e Telekomit të Kosovës, së cilës po ashtu i janë bllokuar llogaritë, edhe pse në tre muajt e fundit Telekomit i Kosovës ka performuar pozitivisht.



Edhe bizneset joaktive përfituan nga Fondi për Rimëkëmbje



Ibrahim Berisha (RFE/RL)

PRISHTINË, 28 TETOR - Disa biznese me status joaktiv në Kosovë dyshohet se kanë përfituar nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike i Qeverisë së Kosovës, që kap vlerën 385 milionë euro, thotë Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit. Nga ky Fond, Qeveria e Kosovës më 28 shtator ka ndarë 60 milionë euro për t'i ndihmuar bizneset që kanë pësuar humbje nga pandemia e shkaktuar nga koronavirusi. Nga kjo vlerë, bizneset kanë përfituar varësisht nga numri i punëtorëve që kanë pasur të regjistruar Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), në muajin dhjetor të vitit 2019. Shahini në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", tregon se disa biznese joaktive ose pasive e kanë keqpërdorur kriterin e Ministrisë së Financave për freskimin e të dhënave në Sistemin Elektronik - EDI në ATK, duke paraqitur llogaritë bankare private. "Realisht këto biznese kanë qenë pasive dhe jozyrtarisht të mbyllura. Në këtë kuadër kanë keqpërdorur ndihmën e shtetit, duke freskuar të dhënat në sistemin e ATK-së. Por, janë raste të izoluara dhe nuk janë shumë, për fat të mirë", tha Shahini. Edhe një kontabiliste nga Prishtina (emër i njohur për

redaksinë), i tha Radios Evropa e Lirë se bizneset që nuk e zhvillojnë veprimtarinë e tyre dhe figurojnë me status joaktiv, kanë përfituar nga Fondi i qeverisë.

Kontabilistja thotë të ketë njohuri për disa biznese të cilat në tri-katër vjetët e fundit kanë pushuar aktivitetin e tyre duke mos paguar asnjë obligim tatimor, rrjedhimisht duke mos paguar asnjë pagë për punëtorët apo obligime të tjera financiare biznesore. Bizneset përfituese nuk kanë pasur nevojë të aplikojnë për këtë subvencion të qeverisë. Kriteri i vetëm i Ministrisë së Financave ka qenë plotësimi dhe freskimi i informatave të tatimpaguesit në Sistemin Elektronik-EDI në ATK. Në këtë sistem është kërkuar që të vendoset numri i llogarisë bankare të biznesit. Kurse është kërkuar që mos të paraqiten llogari individuale/private.

Rreth 80 mijë biznese joaktive

Zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës nuk kanë dhënë informacione se sa është numri i përgjithshëm i bizneseve joaktive në Kosovë. Por, në faqen zyrtare të këtij institucioni, në listën e

tatimpagueseve figurojnë gjithsej 78 522 biznese joaktive.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar një biznes që figuron në këtë listë. Ky biznes është regjistruar në vitin 2010 në Prishtinë, por asnjëherë nuk ka ushtruar veprimtarinë e tij. Pronari i këtij biznesi, që nuk dëshiroi të identifikohet, tha se nuk ka përfituar nga fondit i qeverisë, pasi nuk ka aplikuar dhe as nuk ka bërë freskimin e të dhënave në formularin e ATK-së.

ATK: Në qeveri kemi dërguar listat e bizneseve me status aktiv

Kurse sa i përket mundësisë së përfitimit të bizneseve pasive nga ndihma e qeverisë dhe sa gjatë mund të qëndrojë një biznes me status pasiv, zyrtarë të ATK-së në një përgjigjeje për "Radion Evropa e Lirë", thanë se "sipas kriterëve të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për fondin prej 60 milionë eurosh, ATK-ja ka dërguar listat e bizneseve me status aktiv". "Ndërsa, një biznes pasiv mund të qëndrojë derisa ATK-ja e konstaton në terren se biznesi është duke operuar dhe automatikisht ATK-ja e kthen në aktiv", thuhet në përgjigje.

Kur konsiderohet një biznes joaktiv?

Sipas Ligjit për Administratën Tatimore, tatimpaguesi (biznesi) ka të drejtë ta pushojë veprimtarinë vetëm pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes, dorëzimin e deklaratave tatimore, në afatet përkatëse, duke deklaruar qarkullimin zero. Para se të riaktivizohet biznesi, tatimpaguesi duhet ta njoftojë ATK-në dhe operatorin përkatës dhe pastaj t'i vazhdojë procedurat normale të raportimit përmes Pajisjes Elektronike Fiskale. Nga shuma prej 60 milionë eurosh, që ka ndarë Qeveria e Kosovës, kanë përfituar 36 679 biznese me 206 852 të punësuar. Bizneset kanë përfituar nga 290 euro për secilin punëtor të punësuar.

Gërxhaliu: Të verifikohen listat e bizneseve

Safet Gërxhaliu, ekspert për çështje ekonomike, thotë se çdo ndihmë e qeverisë në këtë situatë është e nevojshme për komunitetin e biznesit, por në këtë drejtim duhet të ketë kujdes të shtuar në listat e

përfitueseve. Ai thotë se qasja e shpërndarjes duhet të jetë shumë transparente dhe të përfitojnë bizneset që vërtet kanë pësuar humbje financiare. "Ato që janë interesante në këtë proces janë dokumentet e Administratës Tatimore të Kosovës, dokumente që është thënë se do të jenë të verifikuara bazuar në raportet financiare. Por, si duket në këtë drejtim kanë depërtuar edhe bizneset e shuara dhe joaktive. Prandaj, besoj se është një momentum, kur ATK-ja bashkë me institucionet e tjera kompetente duhet të jenë më aktive për pastrimin e listave, në mënyrë që të përfitojnë bizneset që meritojnë", tha Gërxhaliu. Përveç ndihmës prej 60 milionë eurosh, Qeveria e Kosovës planifikon që bizneset t'i ndihmojë edhe përmes Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky projektligj, pas gjashtë dështimesh, ka arritur të miratohet në lexim të parë, më 12 tetor, në Kuvendin e Kosovës.

Humbjet e deritashme në ekonominë e Kosovës të shkaktuara nga pandemia, sipas përfaqësuesve të bizneseve, vlerësohen të jenë një miliard euro, kurse deri në fund të vitit mund të humbin mbi 30 mijë vende pune.

Lladrovci përfundon mandatin e kryetarit të Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal

DRENAS, 28 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, në një takim të thirrur nga Agjencia për Zhvillim Rajonal - Qendër, ka dorëzuar mandatin e kryetarit të bordit të kësaj agjencie, i emëruar nga 16 janari i vitit 2017. Me këtë rast, kryetari Lladrovci është vlerësuar me mirënjohje nga AZhR-ja Qendër për përkrahjen e vazhdueshme dhe kontributin e dhënë si kryesues i bordit në avancimin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal-Qendër.

Lladrovci ka falënderuar të pranishmit për bashkëpunimin që kanë pasur gjatë këtyre viteve dhe ka vlerësuar se përkrahja që

u është dhënë bizneseve të Komunës së Drenasit gjatë kësaj kohe ka qenë mjaft e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Ai ka shtuar se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen me AZhR-në, Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe të gjithë aktorët e tjerë për t'i përkrahur dhe mbështetur bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit.

Lladrovci më 16 janar të vitit 2017 ka marrë kryesimin e bordit të AZhR-së, ku janë përfshirë komunat: Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Obiliq, Fushë-Kosovë, Graçanicë, Shtime dhe Drenas.



AZH-R-Qendër ka ndihmuar Komunën e Drenasit në shumë fusha të të bërit biznes. Janë mbajtur sesione informuese me të rinjtë e Drenasit për ndërmarrësi dhe vetëpunësim, përkrahja që u është dhënë

fermerëve të Drenasit, sesione informuese me gratë në biznes dhe fusha të tjera që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në krijimin e biznesit. AZhR-Qendër zhvillon projektet me karakter ndërkomunal dhe

rajonal, si fryt i bashkëpunimit të ARDA-s dhe partneritet të tjera, si dhe pjesëmarrësit kyçë për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit ekonomik rajonal në Kosovë.

Në shkollat e Gjilanit të infektuar me Covid, 16 mësimdhënës dhe 15 nxënës

GJILAN, 28 TETOR (ER) - Në shkollat publike të Gjilanit aktualisht janë 35 raste punonjës të infektuar me Covid-19, prej tyre 16 mësimdhënës, 15 nxënës, një punonjës i administratës së shkollave dhe tre punëtorë teknikë. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, pas takimit me Komitetin e Emergjencave civile për parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Gjendja e tyre është pa simptoma të mëdha dhe në shtëpitë e tyre. Apeloj që t'i bartni maskat, t'i pastroni duart dhe ta ruani distancën mes vete. Jemi në sezonin e vjeshtës me pritje të frikshme, por me besim të madh që kemi për të menaxhuar drejt. Kemi nevojë për lojalitet dhe solidaritet", ka thënë Haziri,



në konferencën për media. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që mos shkojnë në Qendrën Regjionale të Shëndetit Publik për testim, pa simptoma dhe

pa udhëzim të mjekut. Haziri ka njoftuar në fund se deri në fund të muajit nëntor regjioni do ta ketë edhe laboratorin për testim me metodën PCR.

Mblidhet Shtabi Emergjent në Gjakovë, rritet numri i rasteve me Covid

GJAKOVË, 28 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka mbajtur të mërkurën takim me anëtarët e Shtabit Emergjent për Covid-19. Në këtë takim u diskutua për kryerjen e të gjitha detyrave që i takojnë institucionit të Komunës së Gjakovës në luftën kundër virusit Covid-19. Përfaqësues të institucioneve shëndetësore në Gjakovë kanë konfirmuar edhe një herë se në ditët e fundit është rritur numri i

rasteve pozitive me këtë virus. "Ata theksuan se përkushtimi i punëtorëve shëndetësorë, zyrtarëve policorë, inspektorëve të komunës për menaxhimin sa më të mirë të situatës do të vazhdojë edhe më tutje. Ndërkaq është tejet e rëndësishme që të vazhdojë edhe bashkëpunimi nga ana e qytetarëve që t'i respektojnë të gjitha masat e vendosura nga institucionet qendrore", bëhet me dije në njoftimin e Komunës së Gjakovës.



Në Astrazup të Malishevës filloi hapja e rrugës 'Abdyl Frashëri'

MALISHEVË, 28 TETOR (ER) - Në fshatin Astrazup të Malishevës ka filluar hapja, zgjerimi dhe rregullimi i rrugës "Abdyl Frashëri" dhe lidhja e saj me rrugën "Avdullah Morina", duke e ofruar edhe më afër këtë fshat me fshatin Burim. Po ashtu, në kuadër të ndërtimit të rrugëve në këtë fshat, do të ndërtohen në tërësi 1.6 kilometra rrugë, duke e përfunduar kështu të gjithë infrastrukturën rrugore në të gjitha rrugët dhe rrugicat e Astrazupit.

Në fillimin e punimeve në hapjen e rrugës "Abdyl Frashëri", morën pjesë drejtori Komunal i Urbanizmit, Ahmet

Morina, drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër, Bashkim Krasniqi dhe shefi i prokurimit Nuhi Shala, të cilët janë takuar edhe me banorët e kësaj pjese.

Drejtori Morina ka bërë me dije se me rregullimin e 1.6 kilometrave rrugë përmbyllet procesi i ndërtimit të të gjitha rrugëve, në të gjitha segmentet rrugore në Astrazup. Ai ka thënë se njëjtë do të vazhdohet edhe në fshatrat e tjerë, në mënyrë që gradualisht të përmbyllet i tërë procesi i ndërtimit të rrugëve në të gjitha vendbanimet. Ndërtimi i rrugëve në Astrazup mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Franca dhe Gjermania përgatiten për ashpërsim të masave teksa koronavirusi përhapet

PARIS, 28 TETOR - Franca dhe Gjermania pritet t'i ashpërsojnë masat e kufizimit teksa rritet numri i të infektuarve me koronavirus në Evropë. Shtetet e Bashkuara, në anën tjetër, po përballen me normat më të larta të infektimit prej kur ka shpërthyer virusi. Spitalet dhe njësitë e kujdesit intensiv janë duke mbushur në Evropë meqë numri i të infektuarve është dukshëm më i madh sesa në muajt mars dhe prill, kur masat e izolimit patën ndalim hovin e virusit. Gjermania pritet t'i ashpërsojë

kufizimet kur kancelarja gjermane, Angela Merkel, të takohet me udhëheqësit e 16 vendeve ditën e mërkurë. Në mesin e masave që do të shqyrtohen janë edhe mbyllja e restoranteve, bareve dhe muzeve, si dhe ndalimi i organizimeve të tjera. Italia dhe Spanja janë në mesin e shteteve evropiane që janë detyruar të vendosin kufizime të reja për koronavirus, ndërkohë që Franca është duke analizuar nëse mund të aplikojë masa më të vështira. Në kohën e rritjes së shkallës së infektimit, autoritetet ruse

kanë vendosur që vendosjen e maskës ta bëjnë të detyrueshme në hapësira publike, transport publik dhe ashensorë. Rusia renditet e katërta në botë për nga numri i infektimeve të regjistruara, 1 540 000, përfshirë 26 000 vdekje. Në Shtetet e Bashkuara numri i infektimeve brenda ditës është duke u rritur në 47 shtete, derisa i të vdekurve në 34. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", numri i rasteve të reja në ShBA, brenda shtatë ditëve, ka arritur në rreth 73 000.



Senatorët amerikanë përmes rezolutës: Kina po kryen gjenocid ndaj ujgurëve



WASHINGTON, 28 TETOR - Një grup senatorësh amerikanë kanë prezantuar një legjislacion, që deklaron se Kina është duke kryer gjenocid kundër ujgurëve dhe grupeve të tjera etnike, kryesisht myslimane, në rajonin veriperëndimor të Ksinjiangut. "Rezoluta e mban Kinën përgjegjëse sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për Parandalimin dhe Ndëshkrimin

e Krimeve të Gjenocidit", ka thënë senatori, Jeff Merkley, demokrat nga Oregoni. Ai ka theksuar se sulmet e Kinës ndaj ujgurëve dhe grupeve të tjera të minoritetit mysliman, përshkallëzimi i vëzhgimit, burgosja, tortura dhe 'kampet e sforcuara të riedukimit' përbëjnë gjenocid të pastër. "Amerika nuk mund të qëndrojë e heshtur", ka thënë ai. Rezoluta është

prezantuar nga Merkley, bashkë me senatorët tjerë, John Cornyn, Robert Menendez, James Risch, Marco Rubio, dhe Ben Cardin. Kjo rezolutë, që synon të nisë procesin e koordinimit për një përgjigje ndërkombëtare për të ndaluar abuzimet ndaj ujgurëve, ka pak mundësi që të miratohet, sepse Senati nuk do të punojë deri pas zgjedhjeve të javës së ardhshme.

Bërnabiqi: Kosova, sfida më e madhe politike

BEOGRAD, 28 TETOR - Mandatarja për formimin e Qeverisë së re të Serbisë, Ana Bërnabiq, ka nisur paraqitjen e ekspozesë së saj në Kuvendin e Serbisë, përmes së cilës prezantoi përparësitë dhe programin e qeverisë së re para deputetëve. Seanca u hap nga presidenti i Kuvendit, Ivica Dačić, i cili përcaktoi rendin e ditës me një pikë, zgjedhjen e qeverisë dhe betimin e kryeministres dhe anëtarëve të qeverisë, transmeton "Rel". Duke paraqitur planin e qeverisë së ardhshme, Ana Bërnabiq ka theksuar që qeveria serbe do të ketë gjashtë qëllime kryesore, prej të cilave e para do të jetë ruajtja e shëndetit të qytetarëve. Bërnabiq ka shtuar që qëllimet e tjera janë edhe interesat e Serbisë në Kosovë, lufta kundër

mafies, ruajtja e vendimmarrjes së pavarur të Serbisë, përshpejtimi i reformave dhe përparimi ekonomik i vendit. Bërnabiq tha se qeveria e re gjithashtu përballlet me sfida të mëdha politike e, mbi të gjitha, me vazhdimin e dialogut me Prishtinën. Ajo tha se qeveria do t'i koordinojë të gjitha lëvizjet e saj me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić dhe me përfaqësuesit e serbëve nga Kosova, duke theksuar se përparësia është uniteti kombëtar. Bërnabiq, gjithashtu, deklaroi se qeveria e saj nuk do të heqë dorë nga insistimi për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. "Qeveria e re do të vazhdojë ta ndjekë politikën e mbrojtjes së



interesave jetësore kombëtare, të paqes dhe bashkëpunimit, me synimin për ta mbrojtur popullin tonë, trashëgiminë kulturore, por edhe paqen dhe stabilitetin në rajon", theksoi Bërnabiq. Këto qëllime ishin deklaruar më parë nga edhe nga presidenti i Serbisë dhe lideri i

Partisë Progresive Serbe, Aleksandar Vučić. Bashkë me Partinë Përparimtare Serbe (SNS), qeverinë e re do të përfshijë gjithashtu ish-partnerin e tyre, Partinë Socialiste të Serbisë (SPS) të Ivica Dačićit, por edhe Aleancën Patriotike Serbe - SPAS të Aleksandar Shapiq, i cili

ka qenë në opozitë deri më tani. Në qeverinë e re do të ketë edhe parti të pakicave. Katër parti të pakicave kanë kaluar censusin, por ende nuk është bërë me dije se kush do të jetë pjesë e qeverisë. Emrat e kandidatëve për ministrat e ardhshëm u bënë me dije më herët, më 25 tetor, pas seancës së kryesisë së SNS, e cila fitoi më shumë se dy të tretat e mandateve në Kuvendin e Serbisë. Mandatarja për kryeministër, Bërnabiq, deklaroi se rreth 50 për qind e anëtarëve të qeverisë së ardhshme do të jenë gra dhe se 50 për qind do të jenë gjithashtu figura të reja. Sipas saj, gjashtë prej kandidatëve deri më tani nuk kanë asnjë lidhje me qeverinë ose partitë në pushtet.

Rritet numri i civilëve të vdekur nga sulmet e Armenisë në Azerbajxhan

BAKU, 28 TETOR - Në sulmet me artilleri dhe raketa që Armenia ka kryer ndaj vendbanimeve civile në Azerbajxhan deri tani kanë humbur jetën 69 civilë dhe janë plagosur 322 të tjerë. Prokuroria e Azerbajxhanit ka njoftuar për humbjet e jetëve

që sulmet armene kanë shkaktuar që nga 27 shtatori e deri më 28 tetor. Në periudhën në fjalë, përfshirë gra dhe fëmijë, kanë humbur jetën 69 civilë azerbajxhanas dhe janë plagosur 322 të tjerë. Në sulmet e Armenisë

gjithashtu kanë dalë jashtë përdorimit edhe 2 338 shtëpi, 92 apartamente dhe 415 ndërtesa publike. Që kur shpërthyen përplasjet më 27 shtator, Armenia vazhdimisht ka sulmuar civilët dhe forcat e Azerbajxhanit, duke shkëlur

armëpushimet humanitare. Marrëdhëniet midis dy ish-republikave sovjetike kanë qenë të tensionuara që nga viti 1991 kur ushtria armene pushtoi Malësinë e Karabakut, një territor ndërkombëtarisht i njohur i Azerbajxhanit.





Virusi që po e 'ndryshon' anglishten!

Këtë fundjavë unë jam duke u karantinuar me ekipin tim të karantinës. Do të jemi mirë bashkë, pasi të gjithë jemi të lodhur nga Zoom-i në kompjuter. Do të takohemi në ambiente të jashtme, kështu që nuk do të ketë më nevojë për PPM (Pajisje Personale Mbrojtëse), por përsëri do ta ruajmë distancën sociale. Mbi të gjitha, ne nuk jemi kovidiotë (covidots – neologjizëm britanik për të përshkruar ata që nuk kanë frikë nga virusi – shën. i përkth.) dhe sigurisht që nuk duam një valë të dytë. Nëse duhet të mbyllemi për ta rrafshuar përsëri kurbën, përndryshe ky do të ishte një korona-apokalips. Një vit më parë, një paragraf si ky i mësipërm do të kishte qenë i pakuptueshëm. Ndërsa tani ai është i qartë si një mburojë pleksiglas.

Pandemia tetëmuajore ka pasur një ndikim kaq të madh në gjuhën angleze sa që redaktorët e Fjalorit të nderuar të Oksfordit kanë bërë deri më tani dy përditësime speciale për ta dokumentuar atë. Qeveria kanadeze ka përpiluar një fjalor pandemik, me shpjegimet e fjalëve që nga antigjeni deri te zoonoza. Specialisti i zhargoneve në King's College të Londrës, Tony Thorne, ka përpiluar një leksik për lockdown-in (izolimim).

Për shkak të një mikrobi të ri mikroskopik, bisedat tona të përditshme janë të mbushura tani

plot me zhargon mjekësor dhe epidemiologjik, siç janë "ngarkesa virale" dhe "gjurmimi i kontakteve". Paralajmërimet si "Pa maskë nuk hyni dot" janë po aq të kudogjendshme sa tabelat e sinjalistikës rrugore.

Jemi gjithashtu duke përdorur gjuhën për të lehtësuar tmerrin e jetës pandemike, duke përfshirë zhargonet, lojërat e fjalëve, shkurtesat, memet dhe fjalë të reja budallaqe që ndërthurin tingujt dhe kuptimet e fjalëve ekzistuese.

"Ky proces nuk është i ri. Ajo që ndryshon është shkalla e tij", thotë Andrea Beltrama, një sociolinguist në Universitetin e Pensilvanisë. "Kjo është një situatë sociale, mjekësore, psikologjike, politike dhe ekonomike që na prek të gjithëve. Ndikon në argëtim, punë dhe marrëdhënie. Ne tani kemi një pamje të qartë se si formohet gjuha".

A do të zhduket gjuha popullore e pandemisë kur normaliteti (me shpresë) të kthehet?

"Do të jetë interesante të shohim pas 20 vitesh se çfarë ngeci dhe çfarë jo", thotë Beltrama. "Bërja e një fjale pjesë e leksikut është një hap i madh drejt normalizimit të një situatë krejtësisht anormale".

Në shkurt, kryekirurgu amerikan, Jerome Adams, shkroi në Twitter: "Seriozisht njerëz – ndaloni blerjen e maskave! Ato nuk janë efektive në parandalimin e publikut të gjerë nga infektimi me koronavirus!".

Por, studimet që nga ajo kohë kanë treguar se maskat, madje edhe ato prej pëlhure, me të vërtetë ndihmojnë në mbrojtjen e bartësve nga kapja, si dhe përhapja e virusit. ShBA-ja është e vetme në krijimin e mesazheve të rrëmujshme.

Gjuhëtari britanik, Rodney Jones, ka analizuar evolucionin e sloganeve që ishin pjesë e njoftimeve të përditshme të koronavirusit nga dy zyrtarë të Sistemit Kombëtar Shëndetësor Britanik (NHS) dhe kryeministri Boris Johnson, vetë një i mbijetuar i Covid-19.

Në fillim, një pjesë e sloganit "Rri në shtëpi, mbro NHS, shpëto jetën" u shfaq në secilin prej tre podiumeve gjatë informimit të opinionit publik britanik. Por, kjo, spekuloi Jones në artikullin e tij në internet, kishte të ngjarë të çonte në grindje.

"Si mund të rrije në shtëpi dhe të shpëtoje jetë", pyet ai në mënyrë provokative.

Ky problem u zgjidh duke i dhënë secilit podium një poster me të tre frazat e tkurrura dhe të grumbulluara vertikalisht – duke e bërë parullën praktikisht të palexueshme nga disa metra larg. Në maj doli një parullë krejtësisht e re – "Qëndro vigjilent. Kontrolllo virusin. Ruaj jetën".

Autorja e Harry Potter-it, JK Rowling pyeti në Twitter se "A është koronavirusi që nuhat rreth e rrotull? Çfarë dreqin do të thotë 'qëndroni vigjilent'?"

Gjuhëtarja e Universitetit të Oksfordit, Deborah Cameron, shkroi në Twitter se "është një virus, jo një mashtrim në internet ose një komplot terrorist. Çdo të thotë qëndrim vigjilent?".

Në mars, presidenti Donald Trump u kritikua që e quajti koronavirusin "një virus kinez".

"Nuk është aspak raciste, jo, aspak. Vjen nga Kina, prandaj. Unë dua të jem i saktë", tha Trump.

Disa javë më vonë, ai ra dakord të ndalonte përdorimin e kësaj etike ofenduese duke postuar në Twitter se përhapja e virusit nuk ishte faji i aziatiko-amerikanëve "në asnjë mënyrë ose formë".

Mediat digjitale dhe sociale e kanë bërë më të lehtë përhapjen e paragjytimeve dhe ksenofobisë. Kur sifilizi shpërtheu për herë të parë në Evropë në vitet 1400, anglezët dhe italianët e quajtën atë sëmundje franceze. Francezët e quajtën sëmundjen e Napolit. Polakët e quajtën atë sëmundje gjermane. Rusët e quajtën atë sëmundje polake. E kështu me radhë.

Pandemia e gripit në vitin 1918 që vrau 20 milion njerëz në mbarë botën u quajt "gripi spanjoll" – jo sepse dikush e dinte se ku kishte originën, por sepse qeveria spanjolle ishte e sinqertë për shpërthimin në Spanjë, ndërsa vendet e tjera minimizonin ose mohonin atë që po ndodhte brenda kufijve të tyre.

"Gjuha pasqyron dhe përforcon paragjykimet", thekson Beltrama në Penn.

A e dini se karantina vjen nga italishtja "quaranta gjorn"? Do të thotë 40 ditë apo thënë akoma më ndryshe, kjo ishte koha që Venecia i detyroi njerëzit të qëndronin në anije në port për të frenuar epidemitë në shekullin XIV.

Terma të tjerë pandemikë janë të vjetër, por të ripozionuar, duke i shtyrë leksikografët të shtojnë kuptimet e përditësuar.

Disa terma teknike janë shndërruar në simbole.

"Rrafshoni kurbën" është një koncept epidemiologjik, i kompletuar me një grafik tashmë të njohur, që do të thotë frenim i përhapjes së sëmundjes për të shmangur mbingarkimin e spitaleve.

Por, në pranverë, fraza u shndërrua në një qortim për njerëzit që refuzuan masat paraprake.

"Në pak kohë, vura re bare dhe kafene që kishin tabela që thoshin: 'Na ndihmo të rrafshojmë kurëbn', kujton Beltrama.

"Fjalët që hyjnë në fjalorin e ri duhet të jenë të qarta... Nëse doni që kontributi juaj në fjalorin e koronavirusit të jetë i vlefshëm, atëherë ju duhet të loboni jo tek ata që shkruajnë fjalorët, por te miqtë dhe kolegët dhe t'i bëni ata t'i përdorin dhe t'i publikojnë ato", shkruan nga ana e saj revista e njohur "The Economist". /atsh/

Shkrimi i vitit 1939, për disqet me muzikë shqiptare



“La Dépêche” ka botuar të martën e 11 prillit 1939, në faqen e gjashtë, një shkrim të gazetarit, shkrimtarit dhe folkloristit francez Roger Dévigne (tepër interesant për kohën), në lidhje me vlerën kulturore folklorike të disqeve shqiptare dhe mungesën e tyre në mjediset franceze. Shkrimi është si më poshtë:

“Muzeu i tingullit: Disqet shqiptare

“Edhe një herë, thashethemet e tmerrshme të lajmeve na kujtojnë se një koleksion disqesh nuk ka vetëm vlerë muzikologjike dhe rekreative, por edhe vlerë kulturore. Edhe një herë disku, duke evokuar zërat, këngët, lojërat, ëndrrat e popujve të largët dhe pak të njohur mund të na ndihmojë t'i kuptojmë më mirë ato. Do të shtoja: për t'i kuptuar më mirë me hidhërimet e tyre, kur bëhet fjalë, si sot, për shqiptarët.

Francezi, për të cilin thuhet se ka shumë pak njohuri në lëndën e gjeografisë, ende nuk ka shumë reputacion si një dashamirës i folklorit. Sidomos kur bëhet fjalë për folklorin fonografik. Për sa i përket Shqipërisë, në veçanti, pak

francezë dinë për muzikën e saj popullore dhe këngët e saj. Megjithatë, shqiptarët kanë një folklor tingujsh shumë piktoresk, nga i cili janë regjistruar një numër i caktuar melodish (kryesisht nga firmat angleze dhe gjermane). Nëse shqiptarët janë pak si malësorët (highlanders) e Ballkanit (skocezët e lashtë, gjë kurioze, për më tepër, quheshin “Albains” para pushtimit nga skotët e Irlandës) mund të pranojmë, nga ana tjetër, se kënga popullore shqiptare nuk posedon as melankolinë harmonike dhe as madhështinë e egër të këngëve të vjetra skoceze.

Por, ajo ka një aspekt shumë të theksuar territori që e bën atë mjaft karakteristike. Meloditë shqiptare tradhetojnë ndikimin islam shumë më tepër sesa ndikimin sllav. Përjashtojmë

këtu meloditë specifike sllave të Shqipërisë, prej të cilave profesori Mazon, nga Collège de France, ka bërë disa regjistrime të cilat gjenden në Muzeun e Fjalës. Por, nëse ndikimi turk dhe mysliman

është real në meloditë shqiptare, ato ende kanë personalitetin e tyre të përafërt, shijen e tyre të ashpër dhe origjinale.

Në fakt – sipas dijenisë tonë të paktën – ende nuk është bërë ndonjë studim i madh fonografik sistematik i folklorit shqiptar. Dhe kjo është edhe më shumë për të ardhur keq për diskologjinë dhe për shkencën, pasi ngjarjet aktuale nuk do të lehtësojnë, për një kohë të gjatë, kërkimet folklorike të këtij lloji. Në Francë, përveç tre disqeve të Muzeut të Fjalës, nuk ekziston, në asnjë katalog të firmave franceze, asnjë disk nga Shqipëria. Sidoqoftë, mund t'i gjeni në Londër ose Berlin. Tek His Master's Voice do të citoj: diskun n. A. M. 3000. Dy këngë të njohura nga Shqipëria e Jugut, të kënduara në duet, në një regjistër që shkon nga tingulli më i lartë tek ai më i ulët i hundës, të cilët japin një efekt trimërie mjaft piktoresk. Disku n. A. M. 2978, i cili përmban dy këngë të vjetra, përfshirë atë të Ali Tepelenës, pashait të famshëm të Janinës, i cili, siç e dimë, ishte shqiptar. Tjetra është një këngë nga Shqipëria Veriore, e kënduar nga një anëtar i një fisi prej Mati, dhe e shoqëruar nga një treshe violine, klarinete dhe mandoline. Disku n. A. M. 2991. Ai

përmban dy valle kombëtare shprehëse: Valen Çamçe dhe Valen Beratçe, të luajtura nga një orkestër nën tingujt mahnitës të klarinetës.

Shënimi gjithashtu, akoma tek His Master's Voice, një disk me origjinë më pak folklorike, n. A. M. 3017. Është një kor vajzash të reja, që këndojnë në grup dhe që të kujton majft stilin e përgjithshëm të këngëve sllave. Kujtojmë, tek Polydor-i, nga orkestra e Selim Efendiut, disqet n. 51107 dhe 51109. Pa i përkatur specifikisht folklorit, këta disqe janë shumë të larmishëm (shumëngjyrësh) dhe domethënëse.

Tek Odéon-i, nga një orkestër e mirë popullore nga Tirana, vallja ‘Shqiptare’ dhe vallja ‘Beratçe’ (n. A. 237151). Le të përmendim gjithashtu: Gjethia (n. A. 237213); dhe sidomos ‘Bilbilo i mijeri bilbil’ (n° A. 237011).

Nëse do të mund ta gjenit tashmë këtë përzgjedhje të vogël të disqeve shqiptare, do të kishit një pamje (ide) shumë mbresëlënëse të folklorit të këtij populli fatkeq. Marr guximin t'i sugjeroj Odéon-it, i cili po bën, në këtë moment në Paris, një përpjekje kaq interesante dhe të guximshme në interes që do të kishte, nëse kjo është e mundur, për të sjellë një ose dy disqe karakteristike në katalogun e tij shqip”.

/Darsiani/

LE MUSEE SONORE

Disques albanais

Une fois de plus les terribles rumeurs de l'actualité viennent nous rappeler qu'une collection de disques n'a pas seulement une valeur musicologique et récréative, mais encore culturelle. Une fois encore le disque, en évoquant la voix, les chants, les jeux, les rêves de peuples lointains et peu connus peut nous aider à mieux les comprendre. J'ajouterai : à mieux compatir à leurs peines, quand il s'agit, comme aujourd'hui, des Albanais.

Le Français, qui passe pour connaître mal la géographie n'est pas encore très réputé comme amateur de folklore. Surtout quand il s'agit du folklore phonographique. En ce qui concerne l'Albanie, notamment, peu nombreux sont les Français qui connaissent sa musique populaire et ses chansons. Pourtant les Albanais ont un folklore sonore fort pittoresque et dont un certain nombre d'airs ont été enregistrés. (Surtout par des firmes anglaises et allemandes.)

Si les Albanais sont un peu les highlanders des Balkans (les Ecossais antiques, chose curieuse, d'ailleurs, s'appelaient « Albains », avant l'invasion des Scots d'Irlande) on peut concéder, d'autre part, tant plus regrettable pour la discologie et pour la science, que les événements actuels ne vont évidemment pas, d'ici longtemps, faciliter les prospections folkloriques de cet ordre. En France, si nous exceptons les trois disques du Musée de la Parole, il n'existe, dans aucun catalogue de firme française aucun disque d'Albanie. Par contre, on peut en trouver à Londres ou à Berlin. Chez His Master's Voice je signalerai : le disque n° A. M. 3000. Deux chansons populaires de l'Albanie du Sud, chantées, en duo, sur un registre qui va de l'aigu au bourdonnement nasal le plus bas, ce qui donne un effet de rusticité assez pittoresque.

Le disque n° A. M. 2978, qui contient deux vieilles chansons, dont celle d'Ali Tebeleni, le fameux pacha de Janina, qui, comme l'on sait, était Albanais. Ce sont des airs de l'Albanie du Nord, chantés par un membre de la tribu des Mati, et accompagné par un trio de violon, clarinette et mandoline.


Le disque n° A. M. 2991. Il contient deux expressives danses (valle) nationales : Valle camçe et Valle Beratçe, jouées par un orchestre que transper-

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

BALLKANI MUND PRISHTINËN



Përveç Ballkanit, nga tri pikë të mërkurën kanë shijuar edhe Gjilani dhe Drenica. Gjilanasit e mposhtën Besën e Pejës, kurse kuqezinjtë nga Skenderaj triumfuan kundër Trepçës '89

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 28 TETOR - Derbin e javës së nëntë në Superligën e Kosovës në futboll e fitoi skuadra e Ballkanit kundër Prishtinës (2-1). Ndashja e zhvilluar në Suharekë ishte një dramë e vërtetë, ku fituesi u vendos në kohën shtesë. "Kundërshtari provoi të mbrohet dhe të na dënojë me kundërsulme. Në pjesën e dytë bëmë ndryshime taktike, futëm lojtarë sulmues dhe përmbytëm rezultatin. Ballkani po tregon se është skuadër spektakolare si në humbje si në fitore. Kërkoj falje ndaj tifozëve të Suharekës sepse humbëm një ndeshje që duhet ta fitonim, gjithashtu edhe Trepçës '89 ia uroj fitoren. I përgëzoj futbollistët për angazhimin dhe karakterin që shfaqën, pasi pas asaj humbje ishte e vështirë të kthehemi me fitore", ka thënë pas ndeshjes, Ismet Munishi, trajner i Ballkanit. Kryeqytetasit avancuan të parët, kurse vendësit nuk u dorëzuan dhe arritën ta përmbytin rezultatin. Rastet për shënim nuk munguan nga fillimi nga të dyja klubet, por goli i parë u shënuar në minutën e 36, kur Mankenda e kaloi skuadrën mysafire në epërsi (0-1). Edhe në pjesën e dytë rastet nuk munguan, por ishte Ballkani që arriti ta barazojë

rezultatit dy minuta para përfundimit të kohës së rregullt nëpërmjet Mevlan Zekës (1-1). Ish-sulmuesi i Feronikelit ishte në formë të lartë dhe shënoi edhe në minutën e gjashtë shtesë për t'i siguruar tri pikët e plota skuadrës kryesuese. Pas kësaj ndeshje, Ballkani përforcohet në krye të tabelës me 22 pikë, kurse Prishtina është e katërta me 11 pikë. "Një dekoncentrim në defensivë dhe na ndëshkoi me golin e parë Ballkani. Një me një nuk na konvenonte asnjërës skuadër. U munduam të vinim te fitorja, por nuk arritëm të shënojmë. Përkundrazi, pësua golin e dytë dhe humbëm. Diçka nuk shkon. Kemi luajtur shumë mirë dhe u ndëshkuam në fund. Ndoshta dhe fati nuk është në anën tonë", ka thënë Zekirija Ramadani, trajner i Prishtinës. Të mërkurën Gjilani ka marrë tri pikë të plota nga përballja me Besën e Pejës, pasi ka fituar me rezultat minimal 1-0. Goli i vetëm në ndeshjen e zhvilluar në Gjilan u shënuar nga futbollisti mysafir De Paula, i cili shënoi autogol në fund të pjesës së parë. Në pjesën e dytë dy klubet krijuan edhe disa raste shënimi, por rezultati nuk ndryshoi. Pas këtyre tri pikëve, Gjilani është në pozitën e tretë me 16 pikë. Besa është e fundit në tabelë me vetëm 5 pikë. Fitores i është gëzuar

edhe Drenica që e mposhti Trepçën '89 me rezultat 2-1. Në minutën e 66-të, Shkëlzen Lushtaku e zhbllkoi rezultatin, duke shënuar për 1-0. Nëntë minuta pa përfunduar koha e rregullt, Baton Zabërgja realizoi për 2-0, kurse për mysafirët golin e vetëm e shënoi Muja nga penalltia. Drenica është e shtata me 11 pikë, kurse Trepça '89 është një pozitë më lart me pikë të barabarta me kuqezinjtë.

| SUPERLIGA | | |
|----------------------|---|---------|
| Ballkani - Prishtina | | 2-1 |
| Drenica - Trepça '89 | | 2-1 |
| Gjilani - Besa | | 1-0 |
| Feronikeli - Llapi | | 1-0 |
| Arbëria - Drita | | 0-1 |
| Tabela | | |
| 1. Ballkani | 9 | 22 pikë |
| 2. Drita | 7 | 16 |
| 3. Gjilani | 9 | 16 |
| 4. Prishtina | 8 | 11 |
| 5. Arbëria | 9 | 11 |
| 6. Trepça '89 | 9 | 11 |
| 7. Drenica | 9 | 11 |
| 8. Feronikeli | 9 | 10 |
| 9. Llapi | 8 | 5 |
| 10. Besa | 9 | 5 |

SHKURT

Kosova luan miqësore me Shqipërinë

Kombëtarja shqiptare e futbollit do të zhvillojë një ndeshje miqësore me Kosovën më 11 nëntor 2020. FShF-ja ka bërë me dije se miqësorja me Gjibraltarin, e cila ishte planifikuar me këtë datë, është anuluar për shkak të masave kufizuese në kuadër të pandemisë Covid-19, që vështirësojnë udhëtimet e skuadrave. Që prej pranimit të Kosovës në FIFA dhe UEFA, dardanët janë takuar me Shqipërinë vetëm një herë, në një ndeshje miqësore.

Benzema, Mendyt: Mos luaj Vinicius, ai po luan kundër nesh

Sulmuesi Karim Benzema mund të përballet me shumë telashe te skuadra e Real Madridit. Ai është kapur nga kamerat teksa ka akuzuar shokun e skuadrës, Vinicius, që po luan kundër tyre, ndërsa bisedonte me Ferland Mendy gjatë barazimit 2-2 me Borussia Monchengladbach. Francezi u kap nga kamerat në tunelin në 'Borussia-Park' duke diskutuar për 20-vjeçarin gjatë pjesës së parë. Në një bisedë të folur në frëngjisht, Benzema i thotë Mendyt: "Mos luaj me të. Të betohem për jetën e nënës sime, ai [Vinicius] po luan kundër nesh".

Fazlija: Humbja nga Holanda, për shkak të tetë mungesave

Përzgjedhësja e Kosovës në futboll, Afërdita Fazlija, ka thënë se mungesa e tetë lojtareve të ekipit bazë e ka bërë të pamundur të bëhet një paraqitje e dinjitetshme ndaj Holandës në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kosova pësoi 6:0 nga kampionia e Evropës, Holanda, në ndeshjen eliminatorë për Evropianin 2022. "Lojë e vështirë, tetë lojtare të ligës së Kosovës është e vështirë që t'i përballojnë dy ndeshje brenda tri dite, si dhe angazhimi i disa lojtareve të reja, duke debutuar përballë Holandës, ka qenë e vështirë. Mungesa e tetë lojtareve të ekipit bazë na pamundësoi të bëjmë paraqitje më të dinjitetshme", ka thënë Fazlija.

Nëse luajmë kështu, kualifikimi i padiskutueshëm

Madrid, 28 tetor - Golat në minutat e fundit nga Karim Benzema dhe Casemiron shpëtuan Real Madridin nga humbja e dytë radhazi në Ligën e Kampionëve. Gjithsesi strategu francez nuk kërkon që ta bëjë

dramë duelin ndaj Gladbahut. "Rezultati tregon karakterin e skuadrës. Ne e merituar barazimin dhe, ndoshta, edhe më shumë. Më pëlqeu reagimi, është një pikë e rëndësishme. Luajtëm të gjithë ndeshjen,

por është e vërtetë që na mungoi diçka për të fituar. Këtu ka shumë skuadra të mira dhe nuk ka sfida të lehta. Nëse do të vazhdojmë të luajmë kështu dhe të bëjmë gjëra të mira, do ta kalojmë fazën e grupeve", ka

thënë Zidane. "Rikthimi i Hazardit? Ky ishte plani. Duhet ta provoja që të luante. Nuk e dija se kur duhet të kthehej, pasi luajmë çdo tri ditë. Do ta shohim në sfidat në vijim", ka shtuar Zidane.



Grumbullohen 'dardanët'



PRISHTINË, 28 TETOR - Sot (e enjte) grumbullohet Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. "Dardanët" i presin dy ndeshje të vështira në hapje të eliminatoreve për "Euro 2022". Në fazën e dytë kualifikuese për Evropianin 2022, Kosova është në grupin e tetë së bashku me Suedinë, Malin e Zi

dhe Rumaninë. Janë kombëtare të suksesshme, por synimi është i qartë - kualifikimi në "Euro 2022". Nuk do të jetë lehtë, por të gjithë janë të vendosur për hapa më tutje para. Të mërkurën e ardhshme, Kosova luan në Podgoricë ndaj Malit të Zi, kurse më 8 nëntor e pret Suedinë në Prishtinë. Për shkak të ngritjes që

Kosova i ka pasur në vitet e fundit, kualifikimet i nis nga faza e dytë. Lojtarët e Kosovës të enjten paradite fillimisht do të testohen për Covid-19. Prej orës 13:00 akomodohen në "Hotel International" në Prishtinë, kurse stërvitja e parë është prej orës 18:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në kryeqytet.

Sot zhvillohen dy ndeshje në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 28 TETOR - Sot (e enjte) do të zhvillohen dy ndeshje interesante në Prizren. Ponte Prizreni - Golden Eagle Ylli do të jetë një takim shumë interesant, me të dy skuadrat që janë përforcuar dhe kanë synime të mëdha në edicionin e ri. Java e parë do të përmbillet me ndeshjen ndërmjet Bashkimit dhe Trepçës, po ashtu dy rivalë të vjetër. Bashkimi ishte finalist i Superkupës, kurse mitrovicasit siguruan mbijetesën në elitë,



duke mundur AS Prishtinën në "play-out" dhe shpresojnë se do të kenë një edicion më të suksesshëm se ai i kaluari. Takimet do të zhvillohen pa

shikues dhe me praninë e vetëm 50 personave në palestër, duke përfshirë dy skuadrat, zyrtarët e ndeshjes dhe përfaqësuesit e FBK-së.

SUPERLIGA - JAVA 1

Të enjten takohen:
17:00 Ponte Prizreni - Golden Eagle Ylli
19:30 Bashkimi - Trepça

SHKURT

Tusquets emërohet president i Barcelonës

Pas dorëheqjes së Josep Maria Bartomeu, Barcelona të mërkurën emëroi pasardhësin e tij deri në zgjedhjet e reja presidenciale. President i përkohshëm i gjigantit katalanas do të jetë Carles Tusquets. Tusquets do ta kryesojë Barcelonën në muajt e ardhshëm, derisa të zhvillohen zgjedhjet për një president dhe udhëheqje të re, përcjell lajmi.net. Tusquets është një bankier i shquar në Barcelonë dhe zotëron 56 kompani të tjera. Është spekuluar se ai do të jetë një kandidat i mundshëm për presidencën, por deri më tani nuk ka një konfirmim zyrtar. Ai është i njohur për faktin se shpesh është kundër Bartomeu për shkak të kontratave të larta buxhetore të lojtarëve. Anëtarët e tjera në udhëheqje do të jenë: Joan Ramon Ramos (nënkryetar), Joan Lluís Garcia (arkëtar), Josep Maria (sekretar), Miquel Llado (anëtar).

Ish-kampioni i mundjes dënohet me 4 vjet e 8 muaj burg

Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përfunduar gjykimin e Dosjes 339/3, ku në përfundim të gjykimin ka deklaruar fajtorë të pandehurit për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike në bashkëpunim", parashikuar nga Neni 283/2 i Kodit Penal. Gjithashtu, burimet bëjnë me dije se në këtë gjykim edhe kampioni i botës në mundje, Elis Guri është dënuar për prodhim dhe shitje të narkotikëve me shtatë vjet burgim, ku në aplikim të gjykimin të shkurtuar është dënuar përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim.

Modriqi mendon vetëm për Realin

Fokusi i Luka Modriqit është vetëm te Reali i Madridit dhe këtë mesfushori kroat e la të kuptojë në një intervistë të dhënë së fundmi. "Los Blancos" nuk është vetëm e tashmja e ish-Topit të Artë, por edhe e ardhmja sepse, pavarësisht prej kontratës që vlen deri në verën e vitit 2021, periudhë në të cilën do të mbushë 36 vjeç, Luka Modriq kërkon ta vazhdojë aventurën me "Los Blancos" pasi dëshira e tij është një dhe e vetme ta zgjasë kontratën me klubin merengues. Mbetet për t'u parë nëse kampionët e Spanjës do t'ia plotësojnë dëshirën mesfushorit ballkanas, por duke pasur parasysh që Modriqi konsiderohet si një ikonë e klubit dhe është ende shumë i rëndësishëm në fushë për skemat e Zinedine Zidane, gjasat janë që klubi ta lejojë futbollistin ta mbyllë karrierën në "Santiago Bernabeu" duke i ofruar edhe 1 apo 2 vite të tjera kontratë.

Pato, afër rikthimit në Evropë

Alexandre Pato është një prej disa lojtarëve të rëndësishëm që aktualisht janë pa skuadër. Braziliiani po kërkon një ekip të ri në Evropë dhe mediat shkruajnë se mund të rikthehet në Angli, por jo në Premierë Ligë. 31-vjeçari i cili prej muajsh është lojtar i lirë pasi ndërpreu kontratën me Sao Paolon, po negocion me ekipin e Championship, Birmingham të cilët janë në krizë dhe kanë shënuar vetëm 3 gola në 7 javë. Për shërbimet e Patos janë vënë në lëvizje edhe ekipe të tjera si Genoa, Spezia apo St. Etienne.

Hearn: Wilderi nuk mund të luftojë për titullin deri në vitin 2022

Pasi humbi titullin kampion bote në shkurt të këtij viti dhe të drejtën për të zhvilluar trilogjinë në dhjetor, boksieri amerikan Deontay Wilder nuk do të ketë shansin të duelojë sërish për titullin kampion deri në vitin

2022. I këtij mendimi është Eddie Hearn, menaxheri dhe promotori i njohur i boksit. Sipas Hearn, bota po përgatitet për një duel të madh mes boksierëve britanikë Tyson Fury (WBC) dhe Anthony Joshua (WBA, WBO dhe IBF), sfidë që do t'i unifikonte

titujt kampionë bote. Kjo sfidë, apo dy të tilla, do të zhvillohen vitin e ardhshëm, ndaj për Wilderin nuk ka asnjë shans të duelojë për titullin. "Për mua Wilderi tashmë ka përfunduar si boksier. I ka merituar të gjitha fitoret dhe paratë, por tani koha e

tij ka mbaruar. Ndaj, i uroj fat në të ardhmen. Ky është një sport i rrezikshëm, ndaj Wilderi duhet të ketë kujdes në të ardhmen, pasi është më i vjetër se rivalët e tjerë", ka thënë Hearn. "Ajo që mund të them është se Wilderi e humbi shansin e tij, pasi nuk ka

për ta zhvilluar trilogjinë me Fyrin. Ai nuk do të duelojë për titullin kampion deri në vitin 2022, pasi edhe Joshua, nëse fiton ndaj Pulevit, ka për të zhvilluar dy duele të tjera në vitin 2021. Ndaj, për Wilder nuk ka më hapësira", ka shtuar Hearn.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA

STUDENSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
Web:qs.rks-gov.net



Qendra e Studentëve në Prishtinë shpallë :

29.10.2020

KONKURS

Për pranimin e studentëve në konvikte dhe ushqim në mensën e studentëve për vitin Akademik 2020/2021.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit dhe rekomandimet e IKSHPK-së me nr 724, datë 15.10.2020 për Qendërën e Studentëve në Prishtinë lidhur me pranimin-vendosjen e studentëve në konvikte në kohën e pandemisë Covid-19 kërkohet që të respektohen kriteret bazë :

- vendosja vetëm nga një student në një dhomë të konvikteve,
- respektimi i të gjitha masave anti covid të lëshuara nga IKSHPK, MSH dhe institucionet e tjera relevante.

Aplikimi bëhet përmes sistemit ONLINE. Linku për aplikim është i publikuar në web faqen zyrtare të QS-së qs.rks-gov.net dhe në profilin zyrtar në facebook **Qendra e Studentëve-Prishtinë**. Udhëzuesi për aplikim gjendet në linkun e shfaqur.

Në konviktet dhe mensën e QS-së pranohen studentët e rregullt të studimeve themelore, komuna e të cilëve është 25 km e më larg nga Prishtina.

Kriteret për pranim dhe pikët e mundëshme:

1. Studentët nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore me notë mesatare 9.00 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina, pranohen në konvikte pavarësisht totalit të pikëve që fitojnë.
2. Studentët nga fakultetet e tjera me notë mesatare 9.5 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina pranohen në konvikte pavarësisht numrit të pikëve të tubuara.
3. Studentët për notë mesatare fitojnë (varësisht nga nota mesatare).....5 - 15 pikë
4. Largësia nga Komuna e Prishtinës.....2 – 10 pikë
5. Studentët jashtë territorit të Republikës për largësi marrin.....15 pikë

Studentët me status të vaçant për pikë shtesë sipas kategorive:

1. student (fëmijë) i dëshmorit -----10 pikë
2. student (fëmijë) i prindit invalid të luftës -----5 pikë
3. student, prindi i të cilit është veteran i luftës -----4 pikë
4. student i të pagjeturit -----5 pikë
5. student invalid civil i luftës -----5 pikë
6. student i prindit Martir nga lufta -----4 pikë
7. student me aftësi të kufizuara -----6 pikë
8. student i të burgosurit, politik -----4 pikë
9. student me asistencë sociale -----3 pikë
10. dy e më shumë studentë nga një familje aplikant në QS duhet të ngarkojnë leternjoftimin e njëri tjetrit.3 pikë

Të gjithë studentët e këtyre kategorive të cilët përfitojnë pikë shtesë duhet që përmes sistemit ONLINE të ngarkojnë dokumentacionin e kërkuar.

- Studentët prindërit e të cilëve u përkasin kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së vërtetimet, çertifikatat duhet ti marrin në Zyren [ndërtesën] e Qeverisë [ZKM-ZVL]
- Shoqata e të Burgosurve Politik, zyra qendrore Prishtinë
- Shoqata e personave me Aftësi të Kufizuara – Hendikos, zyra qendrore Prishtinë.

- Student i prindit martir nga lufta dhe student i të pagjeturit, vendimi i MPMS dhe çertifikata e bashkësisë familjare.

Sqarim: Njoftojmë studentët se pikët e fituara nga nota mesatare dhe nga largësia llogariten në mënyrë automatike nga SEMS ndërsa studentëve nën asistencën sociale pikët i'u llogariten përmes sistemit online. Andaj nuk është e nevojshme që këto dokumente të ngarkohen gjatë aplikimit.

- Konkursi mbetet i hapur deri me datën **07.11.2020**, nga dita e shpalljes.

Studentët që kanë thyer Rregulloret në fuqi në Qendrën e Studentëve nuk do të pranohen në konvikte.

- Në konvikte do të pranohen studentët me numrin më të madh të pikëve të fituara.

Publikimi i rezultateve bëhet me datë **16.11.2020** në tabelat e konvikteve dhe faqet zyrtare të QSP.

- Afati për ushtrimin e ankesave ONLINE është **17 – 18 nëntor 2020**.

- Publikimi i rezultateve të ankesave bëhet me datën **20.11.2020**.

Drejtorja e Qendrës së Studentëve, Prishtinë

Studentski Centar u Prištini objavljuje:

KONKURS

Za prijem studenata u domovima i ishrana u studentskoj menzi za akademsku 2020/2021.

Na osnovu izveštaja o proceni i preporuka NIJKK-a sa brojem 724 dana 15. oktobra 2020. godine za Studentski centar u Prištini u vezi sa prijemom i smeštanjem studenata u studentske domove tokom pandemije Covid 19, potrebno je ispoštovati osnovne kriterijume:

- smeštaj samo po jednog studenta u sobi studentskog doma,
- poštovanje svih mera anti covid izdatih od strane NIJKK, MZ i drugih relevantnih institucija.

Prijavljivanje se vrši putem ONLINE sistema. Link za aplikaciju objavljena je na zvaničnoj web stranici SC-a qs.rks-gov.net i na zvaničnom Facebook profilu **Studentski centar-Priština**. Vodič za prijavu možete pronaći na prikazanom linku.

U studentskim domovima i menazi SC biće primljeni redovni studenti osnovnih studija, čija je opština udaljena 25 km od Prištine.

Kriterijumi za prijem i mogući bodovi:

1. Studenti Medicinskog fakulteta, Tehničkog fakulteta i Fakulteta Prirodno-matematičkih nauka sa prosečnom ocenom 9,00 i sa udaljenost od 25 km i više od Prištine, primaju se u studentske domove bez obzira na ukupan broj bodova koji dobiju.
2. Studenti ostalih fakulteta sa prosečnom ocenom 9.5 i sa udaljenost od 25 km i više od Prištine primaju se u studentske domove bez obzira na broj prikupljenih bodova.
3. Studenti prema prosečnoj oceni dobijaju (zavisi od prosek ocene 5 - 15 bodova
4. Udaljenost opštine od Prištine.....2 - 10 boda
5. Studenti van teritorije Republike na udaljenosti dobijaju15 bodova

Studenti sa posebnim statusom za dodatne bodove prema kategorijama:

1. student (deca) palih boraca ----- 10 bodova
2. student (deca) roditelja ratnog vojnog invalida ----- 5 bodova
3. student čiji je roditelj ratni veteran ----- 4 boda
4. student (deca) nestalih lica ----- 5 bodova
5. student civilni invalid ----- 5 bodova
6. student čiji je roditelj mučenik (šehid) i heroj ----- 4 bodova
7. student sa ograničenim sposobnostima ----- 6 bodova
8. student (deca) političkih zatvorenika ----- 4 bodova
9. student koji primaju socijalnu pomoć ----- 3 boda
10. dva i više studenata iz iste porodice koji apliciraju za SC mora da dostave međusobno lične karte3 poena;

Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës

3

Svi studenti ovih kategorija koji dobiju dodatne bodove moraju da putem ONLINE sistema dostave potrebnu dokumentaciju.

- Studenti čiji roditelji pripadaju kategorijama koje su poistekle iz rata OVK moraju da dostave potvrdnu, certifikat u Kancelariji (zgradi) Vlade [UP-KRV]
- Udruženje političkih zatvorenika, glavno sedište Priština
- Udruženje osoba sa invaliditetom - Hendikos, glavno sedište Priština.
- Studenti roditelja mučenika rata i studenti nestalih lica, rešenje MRSZ i uverenje o zajedničkom domaćinstvu.

Objašnjenje Obaveštavamo studente da bodovi dobijeni na osnovu prosečne ocene i sa udaljenosti SEMS računava automatski, dok se bodovi studenata sa socijalnoj pomoći računaju putem online sistema. S toga nije neophodno da se ovi dokumenti dostave tokom apliciranja.

- Konkurs ostaje otvoren do **07.11.2020**, od dana objavljivanja.

Studenti koji su prekršili propise na snazi u Studentskom centru neće biti primljeni u studentske domove.

- U studentskim domovima će biti primljeni studenti sa najvećim brojem osvojenih bodova .


Objavljivanje rezultata će biti dana **16.11.2020** na oglasnoj tabli studetskih domova i na zvaničnoj web stranici SCP-a.

Rok za podnošenje ONLINE žalbi je **17 - 18 novembar 2020**

Objavljivanje rezultata na želbe biće dana **20.11.2020**




Direktorijati Studentskog centra, Priština



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ebru Süleyman shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Sami Frashëri", Prishtinë.

► Skender Kaqi shpall te pa vlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

► Pjeter Saliquhaj shpall te pa vlefshme diplomën për agjuntatorë lëshuar nga Q.A.P. – Gjakovë

► Erëza Lajqi shpall të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit të Filologjisë, drejtimi: Gazetari dhe Kontakt me Publikun, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohem*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvaqshme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.



Sh. B. Armagedoni

4⁹⁹ €

Linga e heshtjes • Bujar Salihu

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES

(poezi)



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrare. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema*

kadareane. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku një tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi


Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivuara e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.

Dr. Arben Fetosbi



4⁹⁹ €

Triptikon arbëresh • Arben Veselaj



ARBEN VESELAJ

TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikja, ikonikja)

-  **S. GIORGIO ALB.**
Mbuzati
-  **VACCARIZZO ALB.**
Vakarici
-  **S. COSMO ALB.**
Strighari
-  **MACCHIA ALB.**
Maqi